



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY
Rr. Agim Ramadani, ndërtesa e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383-38-548 644 URL: <http://www.fna.uni-pr.edu> Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 18/17/1 Prishtinë 28.08. 2023

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI HIDROTEKNIK

Studenti **Saranda Hoti** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: " **Studimi I mundësisë së ndërtimit të pendës në lumin Topillë -Shtime**" në programin e studimeve Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Abstrakt

Në këtë temë diplome do të trajtohet mundësia e ndërtimit të pendës në lumin Topillë, Shtime. Qëllimi parësor i këtij punimi është analiza e përgjithshme si dhe rëndësia për ndërtimin e pendës tek lumi Topilla.

Fillimisht kam përshkruar pendat në përgjithësi dhe klasifikimin e tyre, informacionet mbi pozitën gjeografike të komunës së Shtimes dhe pellgut të lumit Topilla, klimës së kësaj komune dhe ndikimin e pendave në ambient.

Për studim, së pari kam zgjedhur që penda të jetë nga materiali rrethor, me bërthamë të papërshkueshme nga uji (material argjile).

Pastaj kam përcaktuar pozitën e pendës në lumin Topilla, në largësi 4.2 km përjetë rrjedhjes së lumit, nga fshati Petrovë. Arsyeja e përcaktimit të pozitës së pendës është bërë e atillë që është vendosur në pjesën e luginës më të ngushtë të lumit dhe gjatësia e kurorës së pendës është $L=127.69$ m. Menjëherë pas përcaktimit të pozitës së pendës, kam bërë analizat hidrologjike dhe kam përcaktuar prurjen minimale $Q_{\min}=0.015$ m³/s, prurjen mesatare $Q_{\text{mes}}=0.10$ m³/s, prurjen maksimale 100 vjeçare $Q_{\text{maks}}=4.90$ m³/s dhe prurjen ekstreme me periudhë kthyesë 10,000 vjeçare $Q_{\text{eks}}=10.20$ m³/s me qëllim të dimensionimit të elementeve të pendës. Kujdes i veçantë i është kushtuar minimumit biologjik i cili është llogaritur të jetë i barabartë me prurjen minimale $Q_{\min}=0.015$ m³/s, në mënyrë që bota bimore dhe shtazore të vazhdojnë të jetojnë në lum.

Pas caktimit të prurjeve hidrologjike, kam bërë dimensionimin e pendës nga materiali rrethor, ku sipas llogaritjeve, penda ka lartësi 42.30 m, gjerësi të kurorës $B=6.00$ m, gjatësi të bazës së pendës $L=182.00$ m dhe pjerrtësi të skarpateve 1:2.

Thellësia e gërmimit për themelin e pendës është paraparë të jetë 4.00 m.

Rezervuari i kësaj pende, duke u bazuar në konturat e terrenit të pellgut llogaritet që të ketë vëllim uji $V=2,510,866.25$ m³. Gjatë dimensionimit të pendës dhe rezervuarit, është llogaritur që kuota e ujit maksimal në rezervuar, të jetë 3.00 m më poshtë se niveli i kurorës së pendës, që të shmanget kapërderdhja e ujit sipër pendës e cila mund të vie deri te shkatërrimi i pendës nga materiali rrethor.

Në fund kam bërë një analizë të shfrytëzueshmërisë së pendës ku kam parë që sasia e ujit që ka rezervuari i kësaj pende, është i mjaftueshëm për të bërë furnizimin me ujë të fshatrave Petrovë, Mollopoc, Reçak, Belincë dhe të pjesës së urbanizuar të komunës së Shtimes, ku sipas llogaritjeve, numri i banorëve për këto vendbanime pas periudhës projektuese 25 vjeçare është 19,400 banorë dhe sasia mesatare e ujit për t'i furnizuar me ujë këto vendbanime është 75.781 l/s.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimit dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimit.